NJOFTIM

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 24.12.2025 “Për përcaktimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026” në Bashkinë Belsh:

- Bashkia Belsh sjell në vëmendje për të gjithë qytetarët dhe subjektet tatimpagues se po afrohet afati përfundimtar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Pasuritë e Paluajtshme (**Tokë, Truall dhe Ndërtesë: *“njësi shërbimi, objekte banim, magazinë”***) për vitin 2026, si dhe detyrimeve të prapambetura.
- Gjithashtu ju bëjm me dije se në zbatim të ligjit 86/2025 “Për Fshirje, Shuarje dhe Pagesën e Detyrimeve Tatimore ndaj Administratës Tatimore Qendrore e Vendore dhe Detyrimeve të Pagueshme në Doganë” :
  - ***Fshihen detyrimet deri në vitin 2014***
  - ***pagesat e prapambetura 2015-2019 kanë zbritje 25%,***
  - ***2020-2024 fshihet kamatvonesa.***

Përfitojnë zbritje të gjithë qytetarët që paguajnë detyrimet deri më 31.12.2026.

Ju lutemi mbani parasysh informacionet e mëposhtme:

- ✓ Afati i pagesës është data 31 dhjetor 2026, mospagimi brenda afateve aplikohet kamatvonesë në masën 1.8% për çdo muaj vonesë (por jo më shumë se 12 muaj), sipas parashikimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- ✓ Për çdo sqarim apo informacion të mëtejshëm, ju lutemi paraqituni pranë Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki ose pranë Njësive Administrative.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!